

MPAY

#777#



Kontroll i Balancës



Pagesë Faturash



Rimbushje Elektronike
(Top-Up)



SMS Alert

Pagesa me Celular

Shpëtoni nga rradhët e gjata dhe kamatëvonesat

www.raiffeisen.al



Raiffeisen
BANK





është mënyra më e thjeshtë për të kryer pagesa nëpërmjet telefonit tuaj celular.



nuk kërkon internet apo smartphone, funksionon edhe në modelet më të thjeshtë të telefonave celularë.



mjafton vetëm që të keni një numër celular aktiv për ta lidhur me shërbimin.



është falas për përdoruesit.

FILLONI TË PËRDORNI MENJËHERË SHËRBIMIN

Pasi të keni përfunduar procesin e regjistrimit hyni në menunë MPAY duke thirrur #777# nga celulari juaj

Vendosni Kodin PIN të Aktivizimit printuar në formularin e regjistrimit

Formoni kodin tuaj personal të sigurisë PIN. Kodi PIN siguron që vetëm ju të keni akses në menunë MPAY

KONTROLL I BALANCËS

1. Hyni në menunë MPAY duke thirrur #777# dhe duke vendosur kodin e sigurisë PIN
2. Shtypni 2 për të zgjedhur Kontroll Balance
3. Menjëherë do t'ju shfaqet gjendja e llogarisë suaj bankare. Shtypni 0 për t'u kthyer në menunë kryesore



PAGESË FATURASH

1. Hyni në menunë MPAY duke thirrur #777# dhe duke vendosur kodin e sigurisë PIN
2. Shtypni 3 për të zgjedhur Paguaj Faturat
3. Shtypni 1 për të paguar faturën
4. Zgjidhni shërbimin për të cilin do të kryeni pagesën dhe më pas vendosni numrin e faturës. Numri i faturës është i vetmi element që duhet të vendosni për të kryer pagesën e faturës suaj apo të miqve dhe familjarve
5. Sigurohuni që keni vendosur numrin e saktë të faturës duke verifikuar detajet dhe konfirmoni pagesën



Faturat e papaguara

Pasi të keni hyrë në menunë **Paguaj Faturat** shtypni 2 për të parë faturat e papaguara. Këtu ndodhen të gjitha faturat e papaguara për kontratat që keni regjistruar në SMS Alert.

Shtypni 3 nëse dëshironi të çregjistroni një kontratë nga SMS Alert

RIMBUSHJE ELEKTRONIKE TOP-UP

1. Hyni në menunë MPAY duke thirrur #777# dhe duke vendosur kodin e sigurisë PIN
2. Shtypni 4 për të zgjedhur Rimbushni Kreditin e Celularit
3. Shtypni 1 për të rimbushur numrin tuaj
4. Zgjidhni vlerën e rimbushjes dhe konfirmoni



Rimbushni një numër tjetër

1. Pasi të keni hyrë në menunë Rimbush Kreditin e Celularit zgjidhni operatorin celular për numrin që do të rimbushni.
2. Vendosni numrin e telefonit celular që do të rimbushni
3. Zgjidhni vlerën e rimbushjes dhe konfirmoni.



SMS ALERT

1. Dërgoni me SMS në numrin 55000 “kodin e tregtarit [hapësirë] numrin e kontratës” për faturat e të cilës dëshironi të njoftoheni, si psh: “vodafone 123456” (“vodafone” është kodi për Vodafone)
2. Do të merrni menjëherë një SMS konfirmuese me të dhënat e kontratës që keni regjistruar.
3. Nëse keni dërguar gabimisht numrin e kontratës përsërisni hapin numër 1 duke vendosur numrin e saktë të kontratës.



Tashmë do të merrni një SMS Alert menjëherë pasi fatura të jetë gati për t'u paguar.

Përgjigjuni për të paguar:

1. Sapo fatura të jetë gati për t'ju paguar do të merrni një SMS njoftuese me të dhënat dhe vlerën e faturës. Përgjigjuni me SMS për të kryer pagesën.
2. Për të paguar ose jo faturën ndiqni udhëzimet në SMS-në njoftuese.

VINI RE! Nëse ju nuk i përgjigjeni 3 SMS rradhazi, shërbimi i njoftimit automatik të faturave (SMS Alert) do t'ju ndërpritet. Pra, në rast se ju dëshironi të vijoni të merrni SMS Alert për kontratat e regjistruara lutemi përgjigjuni SMS-ve perkatëse.

Shënim

Çdo tregtar ka një kod të caktuar për SMS Alert. Një listë të plotë të kodeve mund t'ju gjëni në adresën e internetit www.mpay.al/smsalert ose kontaktoni me bankën. Çdo SMS i dërguar në numrin 55000 do të tarifohet me 10 Lekë/SMS + TVSh nga krediti juaj në celular.

ADMINISTRO LLOGARITË BANKARE

MPAY ju jep mundësinë që të lidhni llogarinë tuaj bankare me shërbimin në më shumë se një nga bankat partnere. Nëse jeni regjistruar në më shumë se një bankë ju mund të zgjidhni në çdo moment llogarinë bankare që dëshironi të përdorni për kryerjen e pagesave apo për Kontroll Balance.

1. Hyni në menunë MPAY duke thirrur #777# dhe duke vendosur kodin e sigurisë PIN
2. Shtypni 6 për të zgjedhur Administro Llogaritë Bankare
3. Do t'ju shfaqet llogaria që jeni duke përdorur aktualisht. Nëse dëshironi të ndryshoni llogarinë kryesore zgjidhni një nga llogaritë në listë.

MPAY është mënyra më e sigurt për të kryer pagesa. Hyrja në menunë MPAY mund të kryhet vetëm nga numri juaj dhe vetëm nëpërmjet një kodi personal të sigurtë PIN.

Disa këshilla për të patur një kod të sigurtë:

- Sigurohuni që kodin PIN t'ia dini vetëm ju
- Sigurohuni që t'ia ndryshoni shpesh atë
- Vendosni një kod PIN të ndryshëm nga ai që përdorni për të hapur telefonin celular apo për të aksesuar shërbime të tjera si kryerja e pagesave nga Kartat e Debitit

PYETJE TË SHPESHTA

- Kam ndryshuar numrin celular. Mund të vazhdoj të përdor shërbimin?

Po, por vetëm pasi të keni shkuar në bankën tuaj për të ndryshuar numrin celular të lidhur me llogarinë tuaj MPAY.

- Kam ndryshuar telefonin. Mund të vazhdoj të përdor shërbimin?

Po, MPAY funksionon me të gjithë tipet e telefonave celular dhe është i lidhur vetëm me numrin tuaj celular, si rrjedhojë mund të ndryshoni telefonin tuaj dhe përsëri të përdorni MPAY në të njëjtën mënyrë.

- Po nëse bart numrin tim celular?

Bartja e numrit tuaj celular nuk do të ndikojë në llogarinë tuaj MPAY për sa kohë do të përdorni një nga kompanitë celulare partnere me MPAY.

- Nuk ndodhem në Shqipëri. Mund të vazhdoj të përdor shërbimin?

Po, mund të përdorni shërbimin MPAY kudo që ndodheni jashtë Shqipërisë. Aksesimi është pa pagesë edhe në këtë rast.

Ju urojmë përdorim të këndshëm të shërbimit MPAY!



Telefon: 04 2 381 381
web: www.raiffeisen.al



Fitoni çdo shtë

Qendra e Informacionit është funksionale 24/7.

Përveç informacioneve që klientët marrin aktualisht nëpërmjet Qendrës së Informacionit, tani ata mund të raportojnë aty edhe problemet me kartat e debitit apo kreditit.

Për më shumë informacion referojuni këndeve "Tarifat për produktet dhe shërbimet tona", të publikuara në çdo degë tonën, tashmë më shumë se 100 në të gjithë Shqipërinë, si dhe në faqen tonë të internetit.

Data e publikimit Prill 2013.